



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqi

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 17 nëntor 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 3(5), 21, 34(12), 40 dhe 41 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 23(7) dhe 56(6) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), Pjesës 5(1)(d) të Udhëzimit të Zyrës Administrative për Vizitat përmes Videolidhjes (Udhëzimi për Vizitat përmes Videolidhjes,¹) dhe nenit 23(1) të Udhëzuesit të Punës për Vizitat dhe Komunikimet ("UP për Vizitat dhe Komunikimet"),² lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 17 nëntor 2023, ZPS-ja dorëzoi një kërkesë urgjente për modifikimin e kushteve të paraburgimit ("Kërkesa"),³ që i kërkonte Trupit Gjykues të urdhëronte masat e përcaktuara në paragrafin 2 të Kërkesës, përfshirë veçimin dhe pezullimin e menjëhershëm, urgjent por të përkohshëm, të të gjitha komunikimeve për Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin ("tre të akuzuarit").⁴

II. DISKUTIM

2. Trupi Gjykues vëren se masat për kufizimin e kontakteve të një të paraburgosuri me botën e jashtme nuk janë në vetvete në mospërputhje me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ")⁵. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues vë në dukje se, sipas nenit 8 të KEDNJ-së, ndërhyrja në të drejtën e një të paraburgosuri për respektimin e jetës së tij private dhe familjare, banesës

¹ KSC-BD-34, 23 shtator 2020.

² KSC-BC-09/Rev1, 23 shtator 2020.

³ F01933, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë Urgjente e Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit*, 17 nëntor 2023, konfidenciale, me Shtojcat 1-5, konfidenciale.

⁴ Kërkesa, para. 2, 53.

⁵ ECtHR, *Khoroshenko v. Russia* [GC], no. 41418/04, Judgment, 30 June 2015, para. 123; *Piechowicz v. Poland*, no. 20071/07, Judgment, 17 April 2012, para. 212; *Silver and Others v. the United Kingdom*, no. 5947/72 and 6 others, Judgment, 25 March 1983, para. 98.

dhe letërkëmbimit, mund të jetë e përligjur në qoftë se është “në përputhje me ligjin”, bëhet për një ose më shumë qëllime legjitime të renditura në nenin 8(2) të KEDNJ-së dhe është e domosdoshme dhe proporcionale me rrethanat.

3. Trupi Gjykes vë në dukje gjithashtu se në përputhje me rregullën 56(6), pa paragjykuar nenin 21(4)(c), në bazë të një kërkesë ose proprio motu, dhe me qëllim mbrojtjen e dëshmitarëve apo viktimave, të informacionit konfidencial apo të integritetit të procesit gjyqësor, ai mund të nxjerrë vendim lidhur me kushtet e paraburgimit dhe çështje që kanë lidhje me paraburgimin, ndër të tjera vendim mbi përcaktimin e kufizimeve të nevojshme dhe proporcionale mbi komunikimet e të paraburgosurit.

4. Informacioni i paraqitur Trupit Gjykes tregon se ekziston një rrezik real që të nxirren informacione konfidenciale për persona që nuk kanë të drejtën t’i marrin ato. Nxjerrja e paligjshme e këtyre informacioneve mund të ndikojë negativisht në mbrojtjen efektive të viktimave dhe dëshmitarëve dhe në integritetin e procesit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes do të urdhërojë masa të përkohshme, të nevojshme dhe proporcionale për të parandaluar nxjerrjen e këtyre informacioneve, në pritje që Trupi Gjykes të mund të vendosë mbi themelësinë e kërkesës së ZPS-së. Trupi Gjykes është bindur se masat e urdhëruara në vijim janë në pajtim dhe në përputhje me mbrojtjen efektive të drejtave themelore të të akuzuarve.

5. Trupi Gjykes ndalon çdo vizitë për tre të akuzuarit nga individë jo të privilegjuar deri në marrjen e vendimit të Trupit Gjykes mbi themelësinë e Kërkesës së ZPS-së. Të gjitha kërkesat për komunikim me persona jo të privilegjuar duhet të miratohen paraprakisht nga Administratorja. Në rastet kur autorizohen nga Administratorja, këto komunikime mbikëqyren në mënyrë aktive dhe Trupi Gjykes autorizon Zyrën Administrative që t’i ndërpresë këto komunikime në çdo kohë kur ekzistojnë rrethana që përligjin këtë masë.

6. Trupi Gjykes thekson se kufizimet e miratuara në këtë vendim nuk zbatohen për kontaktet e privilegjuara me mbrojtësin dhe bashkëmbrojtësin e specializuar

siç përcaktohet në rregullën 111. Gjithashtu, këto kufizime nuk prekin vizitat e posaçme brenda kuptimit të Pjesës 5(1)(d) të Udhëzimit për Vizitat përmes Videolidhjes dhe nenit 23(1) të UP për Vizitat dhe Komunikimet.

7. Sa i përket proporcionalitetit, Trupi Gjykses vlerëson se nuk ka masa që do të siguronin mbrojtjen efektive të dëshmitarëve, të informacionit konfidencial dhe të integritetit e procesit, deri në dëgjimin e parashtrimeve të Mbrojtjes dhe Zyrës Administrative nga Trupi Gjykses dhe marrjen e vendimit lidhur me themelësinë e çështjes. Trupi Gjykses është i mendimit se arsyet e lartpërmendura mbi të cilat mbështetet nevoja për këto masa, vlejné, për të njëjtat arsye, për proporcionalitetin e masave. Trupi Gjykses thekson se këto kufizime miratohen vetëm si masa të përkohshme në pritje të vendimit përfundimtar të Trupit Gjykses mbi themelësinë e Kërkesës. Në vlerësimin e proporcionalitetit, Trupi Gjykses mori parasysh edhe faktin se kufizimet nuk zbatohen për kontaktet e privileguara apo vizitat e posaçme, siç përcaktohet në paragrafin 6 më lart. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vlerëson se masat e përcaktuara në paragrafin 5 janë proporcionale.

8. Për të siguruar efikasitetin e masave të caktuara, Zyra Administrative urdhërohet të informojë menjëherë Trupin Gjykses dhe palët për çdo (dyshim ose përpjekje) për shkelje të urdhrit të Trupit Gjykses, për çdo parregullsi ose vështirësi në zbatimin e urdhrit të Trupit Gjykses.

9. Në këtë fazë, Trupi Gjykses nuk është në gjendje të vlerësojë veçimin dhe pezullimin e menjëhershëm të të gjitha komunikimeve për tre të akuzuarit, pa parashtrimet e Zyrës Administrative dhe të Mbrojtjes. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses urdhëron Zyrën Administrative që deri në **mesditën e së martës, 21 nëntor 2023**, të dorëzojë parashtrime mbi Kërkesën, veçanërisht në lidhje me: (i) realizueshmërinë e masave të kërkuara nga ZPS-ja; (ii) burimet dhe kohën që nevojitet për zbatimin e këtyre masave, nëse urdhërohen; (iii) çdo masë shtesë ose alternative që gjykohet e disponueshme, në varësi të vendimit të Trupit Gjykses,

